



Pranuar / Dorëzuar / Primito / Prezentado / Accepted / Received	14.02.2022	2	viti / god / Year
Organ / Organizata / Organi / Organisation / Org. / Org.	SKPM/SHK	761/2022	1/4

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.26/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani, kryetar - Malore Gashi - Bajraktari, Jeton Koca - anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, për shqyrtimin e ankesës A.Nr.179/2020, të datës 02.07.2020, të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar avokati _____ përmes postës së Kosovës me numër R 9007294, për grupin e ankuesve:

dhe sipas Aktgjykimit A.Nr.1489/20, të datës 12.01.2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamentit për Çështje Administrative, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 14.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.Nr.179/2020 e datës 02.07.2020, e parashtruar nga ankuesit _____ dhe sipas Aktgjykimit A.Nr.1489/2020, të datës 12.01.2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamentit për Çështje Administrative.

II. SHFUQIZOHET, Vendimi i datës 18.06.2020, me numër protokollit 14-070/01-72820 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës.

III. OBLIGOHET Komuna e Prishtinës që të bëjë pagesën e pagës së ndaluar për ankuesit në fjalë, Kryetari i Komunës së Prishtinës duhet që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të zbatojë këtë vendim.

Arsy e tim

Ankuesit dhe me datë 02.07.2020 me numër protokoll 1260/20, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, lidhur me ndalesën e një page për mos paraqitjen në punë nga data 06.06.2019 deri me datë 19.07.2019, sipas njoftimit të E-mailit të datës 09.07.2019 të Udhëheqësit të Sektorit të Bashkësive Lokale, për mos paraqitjen në vendin e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.07.2020 ka përcjell kërkesën për përgjigje në ankesë, në Komunën e Prishtinës lidhur me ankesën e ankueseve të lartpërmendur.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.08.2020 me numër protokoll 1523/2020, ka njoftuar përfaqësuesin juridik avokatin se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A. Nr. 179/2020, të datës 02.07.2020, për ankuesit dhe për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesen që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesit dhe të pakënaqur me njoftimin e datës 12.08.2020, të Këshillit kanë hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 12.01.2022, me numër A.nr.1480/2020, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësve me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 12.08.2020, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.Nr.179/2020, të datës 02.07.2020, të ankuesve: dhe

Administrimi i Provave, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:

Ankesën A. Nr. 179/2020 e parashtruar më datë 02.07.2020 me numër protokoll 1260/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A. Nr.1480/2020, të datës 12.01.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamentit për Çështje Administrative; Njoftimi dërguar përfaqësuesit juridik avokatin Kopje nga origjinali të vërtetuara nga LRP nr.rendor. 589/2020; Njoftim i datës 18.03.2020; E-mail datës 09.07.2019; Kërkesë i datës 27.02.2020; Akt emërimi ankuesit i datës 24.05.2019; Akt emërimi ankuesit i datës 24.05.2019

Akt emërimi ankuesit i datës 24.05.2019; Akt emërimi ankuesit i datës 4.05.2019; Vendimi datës 18.06.2020, me numër protokoll 14-070/01-72820 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës; Ankesë e datës 20.05.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Përgjigje në ankesë E-mail i datës 24.01.2022; E-mail i datës 10.06.2020; Përshkrimi i detyrave të punës; Aktvendim



Cp.nr.3339/16 i datës 05.06.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Përmbartimore; Aktvendim Cp.nr.3339/16 i datës 09.07.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Divizioni Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesat e ankuesve
dhe janë të *bazuar sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar ankesën e ankuesve dhe Aktgjykimin e datës 12.01.2022 me numër A.Nr.1489/2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative me të cilin aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 12.08.2020, të Këshillit, me të cilin aktgjykim Këshillin e ka obliguar që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr. 179/20250, të datës 02.07.2020, të ankuesve
dhe

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesve lidhur me mos pagesën e një page për periudhën nga data 06.06.2019 deri me datë 09.07.2019, gjegjësisht për muajin korrik të vitit 2019, është konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesve janë të bazuara sepse në bazë të njoftimit E-mailit të datës 09.07.2019 të Udhëheqësit të Sektorit të Bashkësive Lokale, ankuesit nuk janë paraqitë në vendin e punës, pasi të njëjtëve ju janë lëshuar Akt emërimet e datës 20.05.2019, duke u bazuar në Aktvendimin me numër Cp.nr.3339/16 të datës 09.07.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinës/Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, mbi këtë bazë Komuna e Prishtinës, ankuesit i ka kthyer në marrëdhënien e punës dhe i ka pozicionuar në pozitat e tyre të punës, të cilët mbi këtë bazë kanë qenë të obliguar që të paraqiten në vendin e punës në pajtim me nenin 59 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, të përcaktuar se: *"1. Nëpunësit civilë janë të detyruar të jenë të pranishëm në vendin e punës në bazë të kushteve të emërimit të tyre dhe gjatë orarit të përcaktuar për funksionimin e institucionit punëdhënës. Nëpunësit civilë janë të detyruar të respektojnë orarin e punës dhe ta shfrytëzojnë atë për kryerjen e detyrave të caktuara. 2. Nëpunësit civilë janë të detyruar t'i informojnë eprorët e tyre për çdo mungesë nga vendi i punës dhe të marrin autorizim për çdo largim nga vendi i punës. Mos informimi ose mungesa e pa lajmëruar nga vendi i punës konsiderohet braktisje e vendit të punës dhe dënohet në përputhje me ligjin"*, duke u bazuar nga data e nënshkrimit të Akt emërimeve të ankuesve të nënshkruar me datë 24.05.2019, dhe se ankuesit me asnjë provë nuk e kanë dëshmuar se janë paraqitë në vendin e punës.

Kolegji konstaton se Komuna e Prishtinës gjegjësisht njësia e burimeve njerëzore me 09.07.2020 ka njoftuar Udhëqësin e nëpunësve për ndaljen e rrogës për një muaj ashtu siç është përshkruar më lartë, por Komuna e Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi gjegjësisht Neni 67 "Masat disiplinore 1. Vetëm këto masa disiplinore mund të zbatohen për shkeljen e detyrave të përcaktuara me këtë ligj: 1.1. për shkelje të lehta aplikohen masat disiplinore në vijim: 1.1.1. paralajmërimi nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; 1.1.2. vërejtja me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 1.1.3. vërejtje me shkrim dhe mbishkrimi në dosjen personale të nëpunësit civil nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion; 1.2. për shkelje të rëndë aplikohen masat disiplinore në vijim: 1.2.1. pezullimi parandalues



me pagesë deri në tre (3) muaj në pritje të një hetimi i cili duhet të propozohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe miratohet nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion. 1.2.2. pezullimi i detyrave dhe ndalimi i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; 1.2.3. largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor; 1.2.4. ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil nga komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension; 1.2.5. pensionimi i parakohshëm për nëpunësit civilë të cilëve u kanë mbetur edhe dy (2) vjet deri në datën e pensionimit” i ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil që ka qenë në fuqi, si dhe Neni 71 Kompetencat e komisionit disiplinor 1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; 1.2. të vendosë, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar, i po të njëjtit ligj.

Prandaj Kolegji Konstaton se Komuna e Prishtinës ka aplikuar një masë disiplinore ndaj ankuesve e cila nuk është e paraparë në dispozitat ligjore dhe si rrjedhojë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale e cila është rrethanë faktike dhe ligjore për aprovimin e ankesave të ankuesve..

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Vendimi i datës 18.06.2020, me numër protokolli 14-070/01-72820 i nxjerrë nga Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj bazuar në këto rrethana Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Nr. A. Nr.26/2022.

Zyle Mililaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit juridik avokatit
- Gjykatës Themelore-Prishtinë, Gjyqtarit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së